



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401173/7

Tiranë ___/___/2014

Lënda: Rekomandohet "Marrja e masave të menjëhershme me qëllim dërgimin e akteve të dosjeve origjinale të automjeteve me targa TR.4362-B dhe TR.2032-L, në pronësi të shtetasit G. Gj., pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë".

Drejtuar : Z.Petrit FUSHA
Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor

Z. Ardian ÇIPA
Drejtor i Drejtorisë së Policisë të Qarkut

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi G. Gj., banues në Tiranë, i cili është pronar me dokumente të rregullta i automjeteve me targa TR.4362-B dhe TR.2032-L. Në datën 20.05.2008, dosjet origjinale të këtyre mjeteve janë sekuestruar për llogari të procedimit penal nr.928 të vitit 2005, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Qytetari Gentjan Gjoka është paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, për të marrë dokumentet për të dy automjetet që disponon, por ai institucion nuk kryen asnjë veprim pa u kthyer dokumentet e sekuestruara.

Në ankesën drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, qytetari G. Gj., ka ngritur shqetësimin për zvarritje të procedurave nga Policia. Ai sqaron gjithashtu se më datën 01.04.2014, ka paraqitur një kërkesë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është regjistruar me numer 992 protokollit, por përsëri e drejta e tij nuk është zgjidhur.

Qytetari G.GJ., duke çmuar korrektesën e Prokurorisë për zgjidhjen e problemit që e shqetëson, nuk ka bërë ankim në Gjykatë ndaj vendimit të sekuestrimit të dokumenteve të marrë nga ai organ, e drejtë kjo që parashikohet në nenin 212 të Kodit të Procedurës Penale. Por, duke parë se e drejta e tij nuk po vihej në vënd i është drejtuar me ankesë Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i pavarur në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Mbi shqetësimin e qytetarit G. Gj., siç jeni në dijeni më datën 18.06.2014, me shkresën nr.K2/G27-4 i kemi kërkuar informacion Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, e cila nga ana e saj më datën 30.06.2014, sipas shkresës nr.5248/1, informon Institucionin e Avokatit të Popullit se:

“Nga verifikimet e bëra në Kartotekën për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë në lidhje me dosjen e pezulluar me nr.928, të vitit 2005, me vendimin e datës 01.10.2010, rezulton se kjo dosje është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr.138, datë 01.02.2013, nga oficeri i Policisë Gjyqësore z.Alfred Shahini, me detyrë specialist në Sektorin për Krimin Ekonomik e Financiar, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë”.

Po ashtu, më datën 18.06.2014, me shkresën nr.K2/G27-3, i kemi kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila më datën 15.07.2014, sipas shkresës nr.9304/1, informon Institucionin e Avokatit të Popullit se:

“Nga verifikimi i kryer në në Zyrën e Rregjistrimit Penal, rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datën 17.03.2005, ka rregjistruar procedimin penal nr.928, për veprat penale të parashikuara nga nenet 174 dhe 186 të Kodit Penal. Pas hetimeve paraprake, më datën 15.06.2005, është vendosur pezullimi i hetimeve. Në datën 03.04.2008, hetimet e procedimit penal nr.928 janë rifilluar, për t'u pezulluar përsëri në datën 01.10.2010, dhe dosja është dërguar për hetime të mëtejshme në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Qytetari G. Gj., nuk ka paraqitur kërkesë për këtë problem në Prokurori në vitin 2014”.

Në përgjigjet tuaja, ka kontradikta dhe nuk del i qartë fakti se ku ndodhen aktualisht aktet e fashikullit të procedimit penal nr.928 të vitit 2005, për të cilin është marrë vendim i pezullimit të hetimit.

Duke analizuar në tërësi rastin e ankesës së qytetarit G. Gj., sipas përgjigjeve tuaja në shkresat përkatëse, vërehet se,

Së pari: Ndonëse ka kaluar një periudhë e gjatë kohë prej mbi 9 vitesh, nga Policia dhe Prokuroria nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore, me qëllim njohjen e autorit të veprës penale, gjetjen dhe administrimin e provave në ngarkim të tij, e mandej vënien para përgjegjësisë ligjore, kërkesë kjo e parashikuar në pikën 1 të Kodit të Procedurës Penale.

Referuar neneve 174 dhe 186 të Kodit Penal, për të cilat organi i Prokurorisë ka filluar procedimin penal nr.928 të vitit 2005, nga ana e juaj duhet të mbahen në konsideratë dhe kërkesat e nenit 66 të Kodit Penal i cili bën fjalë për “Parashkrimin e Ndjekjes Penale”.

Në rrethanat e paraqitura, dërgimi i dosjes së pezulluar nga një organ në tjetrin, pa iu nënshtruar analizave të përbashkëta me detyra konkrete, nuk flet për një punë dhe vlerësim serioz të çështjes. Është detyra e juaj që të konkludohet sa më shpejt për mënyrën e zgjidhjes përfundimtare të procedimit penal nr.928, dhe pas vendimit të marrë të njoftoni dhe qytetarin G. Gj.

Së dyti: Qytetari G. Gj., ndonëse ka dijeni për vendimin e pezullimit të datës 01.10.2010, nga ai moment nuk është njoftuar lidhur me ecurinë e kryerjes së veprimeve si nga Policia ashtu dhe Prokuroria, duke cënuar në këtë mënyrë të drejtën për t'u informuar, e parashikuar në nenin 20 të Kodit të Procedruave Adminiostrative.

Së treti: Prokuroria dhe Policia, për një periudhë të gjatë kohe në dispozicion, i kanë patur të gjitha mundësitë për të konkluduar, për faktin dhe rrethanat në të cilat ai është zhvilluar, për kryerjen e ekspertimeve grafike të shkrimit etj. Praktika të tilla zvarritjeje të çështjeve pa një përfundim nuk flasin për proces të rregullt ligjor e për rrjedhje ato bien në kundërshtim me nenin 6 të Komventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe dispozitat përkatëse proceduriale penale.

Së katerti: Organi i Prokurorisë nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 1 të nenit 213 të Kodit të Procedurës Penale “Kopjet e dokumenteve të Sekuestruara”, si dhe nenit 217 të Kodit të Procedurës Penale i cili bën fjalë për “Kthimin e Sendeve të Sekuestruara”. Në këto dispozita ligjore parashikohet detyrimi i organit procedues, për të lëshuar urdhërin për nxjerrjen e kopjeve të akteve dhe dokumenteve të sekuestruara duke kthyer origjinalet. Kthimi i dokumenteve të sekuestruara nga Prokuroria mund të bëhej edhe para se ajo të merrte vendimin për pezullimin e hetimit, dhe më pas, në rast se do të ishte e nevojshme të urdhëronte sjelljen e tyre nga institucioni që do t'i dorëzonte. Nga mosveprimi i Policisë dhe Prokurorisë për dërgimin e dosjeve origjinale të automjeteve që qytetari G. Gj., i ka në pronësi dhe i disponon me dokumente të rregullta, janë cënuar disa të drejta që lidhen me pamundësinë e tij për të dalë jashtë shtetit, apo për të kryer veprime ligjore si, shitjen e tyre etj. Në këto kushte dhe në bazë të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë Rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* si dhe nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, me ndryshimet përkatëse , i cili shprehet se: *“Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit, paraqet Rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme me qëllim dërgimin e dosjeve origjinale të automjeteve me targa Tr.4362-B dhe TR.2032-L, në pronësi të shtetasit G. Gj., pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë. Lutemi për qëndrimin që do të mbani ndaj Rekomandimit të vihemi në dijeni brënda afatit prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI